

qeap-heimerer

Shpall konkurs për regjistrimin e studentëve të rinjë në:

Programet Bachelor



Shkencat Shëndetësore Infermierore

Infermieri

Profesionistët infermierorë ofrojnë kujdes të pavarur ndaj personave të të gjitha moshave, që kanë nevojë për përkujdesje shëndetësore. Si pjesëtarë aktivë dhe të barabartë të grupit multidisiplinar me profesionistët e tjerë shëndetësorë, ata ofrojnë shërbimet e tyre të bazuara thellësisht në evidencën shkencore.



Shkencat Shëndetësore Terapeutike

Logopedi

Logopedët ndihmojnë klientët që ballafaqohen me probleme të ndryshme në gjuhë dhe të folur. Ata merren me procedurat e vlerësimit dhe trajtimit terapeutik të klientëve – fëmijëve dhe të rriturve – me çrregullime në komunikim dhe gëlltitje. Terapia logopedike është thellësisht e bazuar në evidencën shkencore dhe në parimet biomjekësore. Studentët e Logopedisë janë të privilegjuar të jenë pionierë të këtij profesioni në Kosovë dhe Rajon.



Ergoterapi

Ergoterapeutët (Terapeutët e punës) trajtojnë të gjithë klientët/pacientët që kanë humbur aftësitë e tyre punuese për shkak të ndonjë sëmundjeje a çrregullimi, për shkak të moshës, pengesave zhvillimore apo aksidenteve. Duke zbatuar teoritë ergoterapeutike, ata arrijnë të rikthejnë aftësitë e humbura për përfshirje të pavarur në aktivitetet e jetës tek klientët/pacientët e të gjitha moshave. Studentet e Ergoterapisë janë të privilegjuar të jenë pionierë të këtij profesioni në Kosovë dhe Rajon, pasi që ky program ofrohet vetem nga ne në të gjithë rajonin.



Shkencat Shëndetësore Diagnostike

Laborator

Teknikët e Labororit realizojnë të gjitha llojet e diagnostikës laboratorike shëndetësore. Ata ofrojnë përveç mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e mostrave biologjike, edhe aplikimin e procedurave komplekse laboratorike, vlerësimin dhe interpretimin e rezultateve. Teknikët e Labororit janë pjesë aktive e grupeve multidisiplinare me profesionistët e tjerë shëndetësorë, në harmoni me zhvillimet aktuale shkencore dhe teknologjike.



Shkencat Shëndetësore Pedagogjike

PPSH

Pedagogët shëndetësorë realizojnë dhe menaxhojnë në mënyrë të pavarur informimin, edukimin dhe këshillimin e pacientëve dhe procesin e edukimit shëndetësor në institucionet shëndetësore dhe arsimore. Studentët e Pedagogjisë Profesionale Shëndetësore janë të privilegjuar të jenë pionierë të këtij profesioni unik në Kosovë.

Programet Master



Menaxhim i institucioneve dhe shërbimeve shëndetësore


Programi i Studimeve Master "Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore" ofrohet në kuadër të projektit Tempus të Bashkimit Evropian, në partneritet me Universitetin e Prishtinës dhe katër universitete ndërkombëtare. Menaxherët e Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore zhvillojnë strategji efektive të menaxhimit të shërbimeve, avancimit të kualitetit dhe zhvillimit profesional të ekipit. Ata, gjithashtu, planifikojnë dhe realizojnë projekte të rëndësishme hulumtuese, me qëllim përmirësimin e cilësisë së kujdesit shëndetësor.

Me drejtime inovative, të kërkuara në të gjitha vendet e Bashkimit Evropian, dhe diploma të njohura nga të gjitha këto vende.

Me marrëveshje punësimi me punëdhënës të fuqishëm nga Gjermania dhe vende tjera të Bashkimit Evropian (97% niveli i punësueshmërisë),

Me pjesë studimi dhe praktika profesionale në vendet gjermanfolëse,

Me kurse intensive falas të gjuhës gjermane për studentë.



Lagja Veternik, p.n.
Magjistralia Prishtinë-Gjilan

OP: 09:00 / 17:00

Tel: 038/555-099

Mob: 044/952-462

045/698-210

info@qeap-heimerer.eu

www.qeap-heimerer.eu

Rruga evropiane e karrierës suaj profesionale!